

Shkaçu shirat. Në 3 muaj 62 ditë ishin me shi. Kanë përfunduar mbi 75% e punimeve Turqit; Duam dhe 5 muaj kohë

PËRRENJAS- Segmenti fundor i Koridorit të 8-të në Shqipëri, ai Qukës-Qafë Thanë nuk do të përfundojë brenda vitit, ashtu siç ishte paralajmëruar nga zbatuesi i projektit dhe drejtues të shtetit shqiptar. Për dorëzimin e veprës do të duhen dhe rreth 5 muaj të tjerë. Ky fakt bëhet i ditur nga drejtuesit e firmës turke "Mak-Yol", e cila po zbaton projektin për ndërtimin e këtij segmenti. Shkak për këtë shtyrje në afatin e caktuar, sipas drejtuesve të firmës zbatuese, është moti i keq i muajve të fundit. Gjatë tre muajve, sipas statistikave që ofron ndërtuesi, kanë rezultuar 62 ditë me reshje të shumta që kanë sjellë rëndiment të ulët të punimeve, për shkak të terrenit tepër të vështirë e shkarjeve masive malore mbi aksin e rrugës në ndërtim. Sipas drejtuesve turq, shtyrja e afatit është e motivuar dhe janë marrë që të gjitha masat që punimet të kryhen me intensitet dhe me cilësi. "Deri tani është kryer mbi 75% e volumit të përgjithshëm të punimeve, veçanërisht në sektorët më të vështirë dhe veprat e artit", pohon Nafi Akman, një prej drejtuesve turq të firmës "Mak-Yol". Sipas statistikave zyrtare deri tani rezultojnë të asfaltuara 14 km rrugë, nga 20 km që është gjithsej ky segment rrugor, duke filluar që nga pika doganore. Ndërsa me veprat e artit, që janë jo vërtet të shumta, por dhe të vështira për t'u realizuar për shkak të terrenit të thepisur e kryqëzimeve mbi lumin e Shkumbinit, po sipas statistikave të drejtuesve, janë përgatitur e hedhur në bazamente 33 mijë metro kub beton. Në përmbushje të projektit, firma turke "Mak-Yol" ka shtuar kohët e fundit si fuqinë punëtore ashtu dhe makinëritë e pajisjet. Nga rreth 300 punëtorë që punojnë në këtë segment të Koridorit 8, më shumë se dy të tretat janë punëtorë shqiptarë të zonës si dhe të trevave për rreth (nga Pogradeci, Librazhdë e Elbasani). Segmenti Qukës-Qafë Thanë është segmenti i 5-të i Koridorit 8 në vendin tonë dhe pika lidhëse me vendin fqinj Maqedoninë.

Kujtim Boriçi



Aksion në hotelin "Kidi", në zonën e plazhit. Pranga dhe dy italianëve të tjerë. Shoqërohen në polici dhe 6 shqiptarë

Kapet në Durrës anëtari i "Cosa Nostra"

Arrestohet me 8 kg heroinë italianë i kërkuar Xhankarlo Koliçi. Përdorte 7 identitete të ndryshme


DURRËS - Arrestohet në Durrës një italian i shumëkërkuar, i dyshuar si anëtar i organizatës "Cosa Nostra", një nga organizatat mafioze më të njohura në shtetin fqinj të Italisë, ndërsa janë sekuestruar 8 kilogramë heroinë e pastër që posedohej prej tij. Xhankarlo Koliçi 29 vjeç është shtetas italian i kapur në flagrancë në orët e vona të ditës së djeshme, ndërsa bëhet e ditur se atij i janë bllokuar dhe dy pistoletat tip Zastava. Burime të policisë së Durrësit, - thanë për gazetën se 29-vjeçari përdorte 7 identitete të ndryshme, ndërsa mësohet nga burime jo zyrtare se ai kishte hapur edhe një bar në qytetin bregdetar, të cilin e kishte marrë me qera. Burime të policisë së Durrësit thanë për gazetën se bashkë me shumë të kërkuarin e policisë italiane u ndaluan edhe dy shtetas të tjerë italianë, ndërsa u shoqëruan në Komisarariat edhe gjashtë shtetas shqiptarë. Eñrat e dy shtetasve të tjerë italianë dhe të shqiptarë të ndaluar nuk bëhen të ditur nga policia.

Kanë qenë orët e vona të ditës së djeshme kur uniforma të shumta policie i janë drejtuar hotel "Kidi" një hotel 5 katësh, në stacionin hekurudha të plazhit të Durrësit. Burime të policisë thanë se kishim informacione të sigurta se në këtë hotel strehoeshin shtetas italianë të dyshimtë

heroinë i cili e kalon drogën tranzit nga Shqipëria në drejtim të Italisë. Sipas hetimeve të para përjashtohet një lidhje e munshme e shtetasve italianë të ndaluar me pronarët e hotelit ku ata u kapën. Gjithsesi, thanë burimet do të jenë hetimet e mëtejshme ato që do të saktësojnë pozicionin

VLORE

VLORE - Vendi për ndërtimin e TEC-it të Vlorës nuk u përcaktua as dje në një mbledhje që zgjati mbi tre orë. Përfaqësues të agjencisë kombëtare të energjisë, të Ministrisë së Energjetikës, Mjedisit dhe Turizmit, janë munduar prej tre orësh të bindin pjesëmarrësit në këtë diskutim, për mundësinë e ndërtimit të TEC-it të ri në zonën e portit të ri të Zvërmecit, ku ndodhet edhe pentili i shoqërisë Armo të nafës. Diskutantët, drejtues të pushtetit lokal, prefekti Gjika, kryekëshilltari i qarkut Abili dhe kryebashkiaku Veizi kanë kërkuar më shumë hollësi rreth projektit të këtij TEC-i, ndërkohë që përfaqësuesit e OJQ-ve të mjedisit dhe specialistë të tjerë të energjetikës kanë bërë një opozencë të fortë, duke hedhur idenë e ndërtimit të këtij TEC-i në një qytet zonë të Vlorës, në atë të Akëmisë. Kjo ide është kundërshtuar nga përfaqësuesit e komunës së Novoselës, të pranishëm në diskutim. Sipas tyre ndërtimi i TEC-it në Akëmi do të rezikonte zhdukjen e shumë gjallesave në këtë zonë. Mbrojtësit e projektit për ndërtimin e TEC-it të ri në



Komisariat i Durrësit

e tyre si dhe do të zbardhin rrethjet e këtij rrjeti. Brenda një harku kohor të shkurtër është rasti i dytë që policia e Durrësit kap shtetas të huaj, të implikuar në trafikun e drogës.

Masat

Ndërkohë masa të forta janë marrë edhe në pikën kufitare të portit të Durrësit. Burime të drejtorisë së policisë së Durrësit thanë për gazetën se kohët e fundit, në kuadër të luftës kundër trafikut të çdo lloji janë forcuar masat si nga policia kufitare e portit të Durrësit ashtu dhe nga policia e drejtorisë së qytetit bregdetar. Po ashtu është rritur edhe bash-

këpunimi midis tyre. Duket se kësaj here kanë qenë të efektshme emërimet e reja në portin e Durrësit. Falë punës së drejtuesve të kësaj strukture, gjatë gjithë muajit të fundit, porti ka qenë në qendër të kronikave të rendit, për ndëshkimin e abuzimeve me ligjin.

LL.Kalliço

Përfaqësuesit e komunës së Novoselës nuk kanë pranuar që TEC-i të ndërtohet në Akëmi

Debati; ku do të ndërtohet TEC-i

zonën e portit pranë Zvërmecit, një munduar të bindin të pranishmit me faktin se është një projekt i madh, "një shans që i jepet Shqipërisë nga ana e Bankës Botërore". Teci sipas projektit, do të zërë një sipërfaqe prej 15 ha tokë. Në fazën e parë të ndërtimit TEC-i do të prodhojë 225 megavate dhe në përfundim të fazave të tjera ai do të ketë një kapacitet të prodhimit të energjisë elektrike deri në 400 megavate. Sipas projektit vetëm një njësi e TEC-it, do të prodhojë 3 milion kilovate/orë në ditë, ndërkohë që do të jenë tre njësi të tilla të cilat së bashku do të prodhojnë 1 miliard kilovate/orë në vit. TEC-i është parashikuar të ndërtohet 1,3 km larg nga laguna e Nartës. Specialistët vlonja të energjetikës kanë ngritur shqetësimin e shiut acid, si rezultat i kondensimeve gjatë rënies së shirave, por përfaqësuesit e agjencisë kombëtare të energjetikës kanë thënë se kjo do të jetë e papërfilleshme. TEC-i do të shfrytëzojë ujën e detit për ftohjen e kondensoreve, i cili do të merret 6 km në thellësi të detit dhe do të kthehet

po në këtë distancë. Përkundër këtij projekti nuk po gjendet vendi për ndërtimin e TEC-it. Ndërkohë për gjetjen e vendit Banka Botërore ka

përcaktuar si afat përfundimtar muajin nëntor, me qëllim që të çelen fondet në muajin mars të vitit të ardhshëm.

Ilir Ruci

SHKURT

Të mos kalojë i dyshuari pakistanez
POGRADEÇ - Burime të mirëinformuara policore thanë se dogana e Qafë Thanës dhe ajo e Tushemishtit është urdhëruar që të mos lejojë hyrjen në Shqipëri të shtetasit pakistanez Mahoman Musalio. Burimet për "Shekull-in" thanë se në Tiranë zhvillohet kongresi i Radikalëve dhe një grup i quajtur "Martirët e Allahut" janë shprehur se do ta ndalojnë me çdo kusht kongresin ndërkombëtar. Këto janë masa që merr policia shqiptare për forcimin e kufirit si dhe sigurimin e delegacioneve në kryeqytetin shqiptar. Për personin e mësipërm, sipas të njëjtrave burimeve, ka informacione të dyshimta, pasi ai kërkoi të vijë në Shqipëri. B.Berberi

Djegja e depozitës, pa qëllim
VLORE - Hetimet e policisë së Vlorës lidhur me djegjen e depozitës së nafës në Gonihtë, kanë rezultuar se zjarri nuk është vënë qëllimisht, por për shkaqe të proceseve kimike brenda depozitës. Edhe drejtori i ndërmarrjes së nafës në Gorisht Kristaq Anastasi tha për gazetën se shkaqi i rënies së zjarrit nuk është ndikim i jashtëm, por një reaktion piroferik, i cili zhvillohet brenda në kokën e depozitës. Ilir Ruci

Well-known German producer of Diagnostic Reagents and Equipment for medical laboratory use would like to extend its worldwide business relationship to Albania.

For this reason we are looking for an

Exclusive distributor for diagnostic reagents and systems

Companies established in the area of laboratory and hospital supplies preferably with diagnostic or instrument experience should contact under No.K 258 our agency.

Peter Emrich-WERBUNG
P.O.BOX 1805, D-55008 Mainz
Telefax +49 6131 687021